



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI JURIDIK

Nr. _____ Prot.

Himarë më, ____ / ____ / 2026

Shtojca 15

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

Data: 11/08/2026

Drejtuar: A l b G a r d e n, NIPT K37513520N, Lagjja Skënderbeg, godinë private, 1 – katëshe
në superstradën Lezhë – Shkodër, km 1, Lezhë.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒

JO ☐

- 1) SHPRESA - AL, NIPT K31321021N, adresa: Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga "Urani Pano",
mbrapa "Veve Center", Pallati Nr. 11, Kati 2, Tiranë
- 2) FLORAL, NIPT J68319510L, adresa: Lagjja Beslidhja, Rruga Kosova, Pallati Nr. 128, kati
I-rë, Lezhë.

Tipi i Kontratës: Shërbime

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur mbi kufirin e lartë monetar.

Numri i Procedurës/referenca e Lotit: REF-79017-03-12-2026.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Mirëmbajtje e hapësirave të gjelbëra.

Kohëzgjatja e kontratës: 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: 30.07.2026

**Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin
afatet e ankimit:** Nr. 48 datë 03/08/2026

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- **oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X**

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **A l b G a r d e n**

K37513520N

Vlera: **112 512 600** (njëqind e dymbëdhjetë milion e pesëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind)

Lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO X**

2. **ALKO IMPEX CONSTRUCTION**

K91628013D

Vlera: **129 007 509** (njëqind e njëzet e nëntë milion e shtatë mijë e pesëqind e nëntë) **Lekë pa**

TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO X**

3. **GLAVENICA**

K17710805A

Vlera: **145 502 700** (njëqind e dyzet e pesë milion e pesëqind e dy mijë e shtatëqind) **Lekë pa**

TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO X**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **ALKO IMPEX CONSTRUCTION**

K91628013D

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO X**

Arsyet e skualifikimit: Në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.5 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, operatori ekonomik ka paraqitur Certifikatën Zyrtare nr. 006, në emër të operatorit ekonomik mbështetës “Gjelbërimi 2000” sh.p.k., të lëshuar nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se kjo Certifikatë Zyrtare është lëshuar më datë 10.06.2025. Referuar Modelit 3, Aneksit 4 të VKM nr. 523, datë 13.07.2016, përcaktohet se afati i vlefshmërisë së Certifikatës Zyrtare është deri më 30 prill të vitit pasardhës nga data e lëshimit. Për rrjedhojë, Certifikata Zyrtare nr. 006, e paraqitur nga operatori ekonomik, ka qenë e vlefshme deri më 30.04.2026. Nga verifikimi i dokumentacionit të ofertës rezulton se procedura e prokurimit dhe dorëzimi i ofertave janë kryer pas përfundimit të këtij afati vlefshmërie. Gjithashtu, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion tjetër që

të provojë se, në datën e dorëzimit të ofertës, dispononte një Certifikatë Zyrtare të vlefshme, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.5 të Dokumenteve Standarde të Tenderit. Për sa më sipër, vlerësohet se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik nuk provon përmbushjen e kriterit të veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.5 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, pasi Certifikata Zyrtare e paraqitur nuk ka qenë e vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertës. Nga komunikimi zyrtar ndërmjet AK dhe Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve rezulton se nga data 30 Prill 2026 kjo certifikate nuk është më e vlefshme.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se ai nuk përmbush kriterin 2.1.3 të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim, të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit. Konkretisht, në dokumentet e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për veprimtarinë “Prodhimi dhe tregtimi i farave dhe fidanëve” (Kodi II.4). Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, si dhe nga verifikimi në regjistrin zyrtar të licencave/lejeve të lëshuara nga QKB, rezulton se operatori ekonomik nuk disponon licencën e mësipërme. Për sa më sipër, operatori ekonomik “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” sh.p.k. nuk përmbush kërkesën e përcaktuar në pikën 2.1.3 të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim dhe, për rrjedhojë, nuk plotëson një nga kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi, për rrjedhojë skualifikohet.

2. GLAVENICA

K17710805A

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO

Arsyet e skualifikimit: Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes

Nuk ka paraqitur licencë të vlefshme të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL), Kategoria III.2 “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis: nënkategoria III.2.B për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane, kodi: 17 05 04 dhera dhe gurë të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03

Nuk ka paraqitur Liçensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për “Deratizim, dezinfektim, dezinfektim” (Kodi II.8.B).

Nuk ka paraqitur bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre

Nuk plotëson kriterin për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër. Kontrata e paraqitur nuk është realizuar në 3 vitet e fundit.

Nuk disponon 2 manovratore për pajisjet e renda

Nuk ka deklaruar fuqinë punëtore për muajin e fundit që duhet të ishte muaji maj dhe jo prill 2026

Nuk ka paraqitur certifikatë fitosanitare, sipas modelit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe me certifikatë zyrtare, të lëshuar nga autoriteti certifikues, sipas modeleve 2 dhe 3, të aneksit 4, bashkëngjitur VKM nr. 523 datë 13.07.2016.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë**, adresa: **Eko Muzeu, Himarë fshat, Himarë** brenda **5** (pesë) **ditëve** nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO ☒

Nëse Po: _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Themistokli FOTO